



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 250/2014
Datë: 5 shtator 2014

Në bazë të nenit 4 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Rregullores për Funkcionimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës Rregullores për Procesin e Rekrutimit, Emërimit dhe Ri-emërimit të Prokurorëve, në mbledhjen e mbajtur me datën 5 shtator 2014, Këshilli Prokurorial i Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet neni 4 pika 9 e Rregullores Nr. 03/2013, për procesin e rekrutimit, emërimit dhe ri-emërimit të Prokurorëve, e datë 30 shtator 2013, me nr. 1045/2013.
- II. Pika 9 e nenit 4 të Rregullorës, fshihet teksti " Për kandidatet për prokurorë në Prokurorinë Speciale, Komisioni për emërim do të përbehet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës".
- III. Pika 9 e nenit 4 të Rregullores ndryshohet me tekstin, " Për kandidatet për prokurorë në Prokurorinë Speciale, Komisioni i Emërimit do të jetë i përbërë nga, Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe një prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit".
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikoj në ueb faqën e KPK-së dhe PSH-ës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Sylë Hoxha
Kryetar i Këshillit Prokurorial

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të ZKPSH;
- Arkivit të PSH-së/KPK-së.